

BIBLIOTEKA

E

814-1

26. 61

SHTETIT

GJIROKASTËR

PETRAQ DHIMA

*Më  
presin*

**poezi**



SH-1  
84. 61.

Petraç Dhima

MË  
PRESIN

poezi

49272

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

1-19-30  
6-10-30

*Redaktor*  
LLAMBRC RUCI

LLAMBRC

LLAMBRC RUCI

## MOTIV MESNATE

Erdh mesnata, erdh vërtet,  
me dremitjen në qepallë,  
veç motivi nuk më ndahet  
këlthet vargu si i gjallë.

Befas dhomën mbush një qarje,  
befas dhomën mbush një zë,  
është fëmija disaditshe  
nëna e saj në gji e vë.

Hesht fëmija kur te gjiri,  
duke thithur, qumësht pi,  
veç kështu rritet e rritet  
kur te gjoksi i nënës rri.

Dhe motivi si fëmija  
brenda gjoksit më këlthet,  
ta shkallmon kraharorin,  
i ngarkuar është me jetë...

## SHQIPONJAT

Shqiponjat janë vetë liria,  
kur ngrihen qiellit fluturim...  
Hapësira e gjerë  
hapësira e kthjellët,  
pa to s'do kishte kurrë kuptim.

## KAMBANA E ZËRIT

Ti, Partia ime, ke hyrë në vatra tona  
dhe zjarrin e jetës ndezur na e mban.  
Edhe pse koha është e mbarsur me tufane,  
dritë e ngrohtësi  
përhap ti në çdo anë.

E ç'do të isha unë pa frymën që më ngroh,  
pa dorën që në rrugën e madhe më drejton?  
E zëri im ç'do të ishte në rrugët e jetës?  
— Një këlthitje e humbur  
që kush s'e dëgjon.

Ti, Partia ime, je forca që më rrit  
e jehonë prej kushtrimi i jep zërit tim;  
në ballë të kohës ti je kambanë sulmi  
nga merr udhë  
kumbues zëri im.

## NË FSHATIN AGIM\*)

Agimi, fshati i së dashurës sime,  
me njerëz, rrugë, shtëpi të zakonshme,  
dikur ka pasur emrin Çiflig  
që rrallë përsëritet në ditët e sotme.

Beu të gjitha i kishte të tijat:  
tokën, rrugët, gjethet e pemët,  
veçse dashurinë e njerëzve kurrë  
s'e bëri strehë që të vendoste zemrën.

---

\*) Agimi — fshat në Myzeqe

## FUND TETORI

Ky plepi, ja, të verdhat gjethe  
një nga një zë e i shkund  
dhe toka nis e i tërheq  
kur era lehtë i lëkund.

... Dhe zhvishen pemët. Degët bosh  
mbeten braktisur prej blerimit,  
rrugën e largët nisin zogjtë  
me të drejtën e rikthimit.

Por ja, pas tij vjen nëntori  
festiv, gjëmues shkrepëtin,  
rrezet e tij të kuqe flakë,  
bien gjithkund, na përtërijnë.

Pemët, jo, s'do mbeten shkretë  
ku të fryjë veç era e dimrit,  
ato do mbushen me flamuj  
nëntori të kuq e ka ngjyrimin.



## GJURMËT E PËRGJAKURA

Ata marshonin pa u ndalur  
mbi brinja malesh, në thëllim.  
Qielli mbi ta hidhte dëborë,  
mali derdhte suferinë.

Dikush nuk kishte as opinga,  
as këpucë, as çizme s'kish,  
i fortë si kreshnik legjendash  
ecte para nëpër ngricë.

Këmbët seç pikonin gjak  
edhe linin gjurmë të kuqe,  
gjurmët ishin për të ardhmen  
drita nëpër rrugë lufte.

Hiqte opingat e tij shoku,  
i thosh: ndalo, vëlla, sërish  
duhet të eci unë i zbathur  
që ti i vetëm të mos ngrish.

Rrugës opingat qarkulluan  
partizanët këmbë më këmbë  
Vetëm kështu plaga e shokut  
në të gjitha zemrat dhëmb.